



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

MIRATOHET

KRYETARË

Lindita NIKOLLA



REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
PËR VITIN 2023**

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e veçantë të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në qasjen për forcimin e kulturës së garantimit të standardeve më të larta në ushtrimin në praktikë të të drejtës për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale;

Duke vlerësuar rolin aktiv të këtij institucioni në procesin e integritetit në Bashkimin Evropian, specifikisht për kontributin në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale;

Duke vlerësuar veprimtarinë e institucionit në përmbylljen e procesit të përmirësimit të legjislacionit në fushën e të drejtës për informim;

Duke vlerësuar bashkëpunimin e ngushtë dhe konstant me qytetarë apo grupe interesi, autoritete publike, subjekte juridike në sferën private, organizata të shoqërisë civile dhe medien;

Shqyrtoi veprimtarinë e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2023 dhe konstaton se:

Ka realizuar plotësisht rekomandimet e lëna në rezolutën e datës 8.6.2023 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, si dhe rekomandimet e adresuara nga raporti i progresit për vitin 2023 për Shqipërinë.

Ka dhënë kontribut parësor në përmbylljen e procedurave për modernizimin e kuadrit ligjor në fushën e të drejtës për informim nëpërmjet miratimit të ligji nr. 78, datë 21.9.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit””.

Ka dhënë kontribut aktiv në përmbylljen e procesit për miratimin e legjislacionit të ri në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale në bashkëpunim me partnerët vendas dhe evropianë.

Ka vijuar procesin e monitorimit dhe mbikëqyrjes për verifikimin e përditësimit të Programit të Transparencës të autoriteteve publike, si dhe në ndihmë të tyre ka miratuar udhërrëfyesin për zbatimin e programit institucional të transparencës.

Nëpërmjet procesit të shqyrtimit administrativ të ankesave ka nxitur përmirësimin e transparencës, duke angazhuar autoritetet publike për përmbushjen e detyrimeve në vendosjen në dispozicion të publikut të informacionit.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, ka nxitur dhe dhënë kontribut në hartimin e akteve nënligjore.

Në funksion të zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale nga subjektet politike ka dhënë kontribut aktiv duke miratuar udhëzuesin “Për përpunimin e të dhënave personale në kontekstin e fushatave zgjedhore”.

Ka zhvilluar hetime administrative me objekt tematik për zbatimin e masave tekniko-organizative për përpunimin e sigurt të të dhënave personale, veçanërisht për sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit (SMSI), si dhe në fusha e sektorë me ndjeshmëri të lartë.

Është ndjekur me prioritet procesi verifikues i zbatimit të masave të lëna në rekomandimet e mëparshme, si në sferën publike, ashtu edhe në atë private, duke vendosur edhe sanksione administrative në rastet e mospërmbushjes së tyre.

Në kuadër të aspektit ndërgjegjësues, është angazhuar në organizimin e aktiviteteve të kësaj natyre në të dyja fushat e përgjegjësisë, edhe në bashkëpunim me organizata të shoqërisë civile, për nxitjen e qytetarëve në ushtrimin e këtyre të drejtave dhe respektimin e tyre nga institucionet publike dhe entitetet private.

Ka luajtur rol aktiv në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar me autoritetet dhe organizatat homologe dhe më gjerë në të dyja fushat e veprimtarisë.

Kuvendi i Shqipërisë kërkon që Zyra e Komisionerit për vitin 2024, në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj, të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:

1. Të luajë rol aktiv në përmbylljen e procedurave për miratimin e kuadrit ligjor/nënligjor për fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, për të drejtën e informimit, si dhe për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik.

2. Të thellojë mbikëqyrjen dhe monitorimin e zbatimit të legjislacionit për të drejtën e informimit, duke patur si qëllim rritjen e llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së administratës publike/shtetërore për garantimin e transparencës proaktive apo nivelit të lartë të aksesit në informacion publik.

3. Të vijojë procesin e monitorimit dhe asistencës në instalimin dhe funksionimin e instrumenteve elektronike, të cilat janë alternativë e vlefshme për forcimin e transparencës së autoriteteve publike.

4. Të ushtrojë hetime të thelluara për zbatimin e detyrimeve të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale si në sferën publike, ashtu edhe në atë private, në fusha e sektorë si ai i arsimit, shëndetësor, bankar, turizmit etj.

5. Të rrisë mbikëqyrjen tematike për masat tekniko-organizative, specifiku për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) në funksion të ruajtjes së konfidencialitetit, integritetit, disponueshmërisë dhe besueshmërisë në procesin e përpunimit të të dhënave personale.

6. Të rrisë ndërgjegjësimin në funksion të transparencës proaktive, me qëllim uljen e ankesave dhe zbatimin e afateve ligjore në dhënie të informacionit.

7. Të mbikëqyrë dhe monitorojë zbatimin efektiv të rekomandimeve të lëna më herët nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

8. Të angazhohet dhe bashkëpunojë me institucionet përkatëse për forcimin e kapaciteteve profesionale të stafit të Zyrës së Komisionerit dhe të institucioneve publike/private për

përbushjen e detyrimeve ligjore lidhur me fushat e përgjegjesisë, si: të drejtën e informimit, mbrojtjen e të dhënave personale dhe ripërdorimin e informacionit publik dhe menaxhimin e të dhënave të hapura.

9. Të zhvillojë procesin monitorues/mbikëqyrës pranë prokurorive për zbatimin e legjislacionit të fushës dhe detyrimeve që burojnë nga marrëveshja e bashkëpunimit me Eurojust për mbrojtjen e të dhënave personale.

10. Të hartojë një kurrikul profesionale në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale si standard për trajnimet apo dhe si një mundësi për zbatim nga sistemi arsimor.

Miratuar në datën 4.7.2024